REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 1772 **Prot**

Vlorë,më 06.07.**2026**

VENDIM

Nr. 09 *datë* 29.06.*2026*

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË BUXHETIN E KËSHILLIT TË QARKUT VLORË PËR VITIN 2026, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 25, DATË 22.12.2025, I NDRYSHUAR

Këshilli i Qarkut Vlorë pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur, nga grupi i punës për përgatitjen e buxhetit të Këshillit të Qarkut Vlorë të vitit 2026, mbështetur në:

- *Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, konkretisht nenit 8, pika 2; nenit 9, pika 1.1, germën "b"; nenit 31, pika 1.2.3; nenit 34; nenit 38; nenit 40; nenit 41; nenit 72, pika 5; nenit 77, pikën "dh"; dhe nenit 83, pikën "ç"; Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 40; Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 06, datë 27.02.2026, "Për përgatitjen e programit buxhetor vendor afatmesëm 2027–2029";Shkresën nr. 15867 prot., datë 06.11.2025, të Ministrisë së Financave, "Për transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale për vitin 2026";VKM nr. 783, datë 09.11.2016, "Për miratimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Republikës së Greqisë dhe Komisionit Europian, për programin INTERREG IPA të bashkëpunimit ndërkufitar Greqi–Shqipëri, 2014–2020";VKM nr. 765, datë 12.12.2022, "Për miratimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë, për vitin 2021, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraëanëtarësimit (IPA III)"; Ligjin nr. 65/2022, datë 15.9.2022, "Për ratifikimin e marrëveshjes Financiare kuadër të partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat specifike të zbatimit të Asistencës Financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë në Kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraëanëtarësimit (IPA)";Ligjin nr. 75/2024, datë 25.7.2024, "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Republikës Helene dhe Komisionit Evropian për programin e bashkëpunimit ndërkufitar (Interreg VI-A) IPA Greqi–Shqipëri 2021–2027";Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 20.9.2023, "Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësëve dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave për menaxhimin indirekt të asistencës financiare të Bashkimit Evropian nën Instrumentin për Asistencën e Paraëanëtarësimit 2021–2027 (IPA III)";Udhëzimit të MFE nr. 31, datë 18.11.2022, "Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit"; Vendimit të*

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Këshillit të Qarkut nr. 25, datë 22.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 për Këshillin e Qarkut Vlorë";-Vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 04, datë 30.03.2026, "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e Këshillit të Qarkut Vlorë të vitit 2026, të miratuar me VKQ nr. 25, datë 22.12.2025".

V E N D O S I :

1. Të miratohet shtesa në Kapitullin 2 në vlerën totale 14,706,055 lekë, si parafinancim për projektet me financim të huaj, sipas detajimit të mëposhtëm:

1.1. Parafinancim në vlerën 3,079,044 lekë për projektin CSRDatSME.
1.2. Parafinancim në vlerën 11,627,011 lekë për projektin TRANSPORT.SAF.ER.

2. Të miratohet shtesa në buxhetin e vitit 2026 në Kapitullin 5, nga të ardhurat e vitit 2026, si më poshtë:

2.1. Shtesë në vlerën 20,239,831 lekë nga transfertat e bashkive të qarkut.
2.2. Shtesë në vlerën 500,000 lekë në llogarinë 600.
2.3. Shtesë në vlerën 500,000 lekë në llogarinë 601.
2.4. Shtesë në vlerën 51,540,454 lekë në llogarinë 604.
2.5. Shtesë në vlerën 31,285,717 lekë në llogarinë 231.

3. Të miratohen detajimet e këtyre ndryshimeve si më poshtë:

3.1. Ndryshime në Kapitullin 2 — Parafinancim:
- Të shtohet vlera 3,079,044 lekë në Kapitullin 2, si parafinancim për projektin CSRDatSME, me shpërndarjen e mëposhtme sipas llogarive ekonomike:
- *Llogaria 602: 3,079,044 lekë.*

- Të shtohet vlera 11,627,011 lekë në Kapitullin 2, si parafinancim për projektin TRANSPORT.SAF.ER, me shpërndarjen e mëposhtme sipas llogarive ekonomike:
- *Llogaria 602: 1,200,000 lekë;*
- *Llogaria 230: 2,348,691 lekë;*
- *Llogaria 231: 8,078,320 lekë.*

Vlera totale e shtesës në Kapitullin 2 është 14,706,055 lekë.

3.2. Ndryshime në Kapitullin 5 — Të ardhura:
- Të shtohet vlera 20,239,831 lekë në Kapitullin 5, si shtesë nga transfertat e bashkive të qarkut.
- Të shtohet vlera 500,000 lekë në llogarinë 600.
- Të shtohet vlera 500,000 lekë në llogarinë 601.
- Të shtohet vlera 3,066,870 lekë në llogarinë 602.
- Të shtohet vlera 51,540,454 lekë në llogarinë 604, si transfertë për bashkitë e qarkut, sipas detajimit të mëposhtëm:

- *26,388,440 lekë transfertë për Bashkinë Delvinë për "Rikualifikim i rrugëve të fshatit Kopacëz, Bashkia Delvinë";*
- *4,764,163 lekë pjesa e dytë e transfertës për investimin "Rikonstruksion i fushës së Bamatatit, Bashkia Delvinë".*
- *20,382,613 lekë transfertë për Bashkinë Konispol për "Rikualifikim i rrugëve të fshatit Kopacëz, Bashkia Delvinë""Rikonstruksion i Rrugës Kamare-"Shkolla Ciflik", Bashkia Konispol";*

- Të shtohet vlera 31,285,717 lekë në llogarinë 231, sipas detajimit të mëposhtëm:

• 31,285,717 lekë bashkëfinancim në projektin TRANSPORT.SAF.ER për "Ndërtim i rrugës Kalivua–Xarrë, Bashkia Konispol".

Ndryshimet e detajuara në Kapitujt 2 dhe 5 janë pasqyruar në relacionin bashkëlidhur.

4. Ndryshimet e nevojshme të pasqyrohen në dokumentin përfundimtar të PBA 2027-2029.

5. Kryetari i Këshillit të Qarkut autorizohet të bëjë transferimin e fondeve operative, pa limit, për artikujt e miratuar nga Këshilli i Qarkut, brenda institucionit.

6. Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social pranë Këshillit të Qarkut autorizohet të bëjë ndarjen e fondeve të miratuara nga Këshilli i Qarkut, sipas strukturës buxhetore të miratuar nga Ministria e Financave për çdo muaj.

7. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, i ndryshuar.

Grupi i punës:

Anisa Hyseni
Drejtor i Drejtorisë së Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social

Mauricio Pashaj
Specialist Finance për Zbatimin e Buxhetit

Alma Myrtaj
Specialist Jurist

Blerina Lula
Specialist për Urbanistikën dhe Zhvillimin e Territorit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Ilda Lamaj
Specialiste për Arsimin, Kulturën, Turizmin,Çështjet Sociale dhe Zhvillimin e Projekteve

Vanina Vongli
Specialist për Zbatimin e Projekteve

Rea Shkreli
Specialist i Protokollit - Arkivës dhe Burimeve Njerëzore

Palush Naçi
Specialist për Shërbimet, Transportin dhe Emergjencat Civile

KRYETARI

Ervis MOÇKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I QARKUT VLORË

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600